[Shqiptarja.com]

E diel 24 Shtator 2023 - Përditësimi i fundit 17:02

Flash Vrasja e efektivit në Zveçan, burime raportojnë për 7 serbë të vrarë dhe një tjetër i arrestuar

VRITET POLICI NË KOSOVË ZGJEDHJET NË KUKËS

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 E pushtuar nga flakët, kush është pronari i 'Deutsch Color', biznesmeni shqiptar që investoi në Tunizi

2 I veshur me uniformë të Njësisë Speciale Serbe 'Kobra', publikohet fotoja e njëri prej sulmuesve serbë të vrarë në veri të Kosovës

3 Tiranë/ Polici i Vlorës nuk i bindet urdhrit për kontroll, dhunon bashkë me dy miqtë efektivin e Shqiponjave

4 Përgjaket veriu i Kosovës, Deputetja britanike: Të gjithë ata që e kanë nisur këtë sulm do japin llogari dhe do dalin para drejtësisë

5 Dalin Fotot/ Ja formacioni i armatosur që vrau efektin në Kosovë, të veshur me veshje ushtarake e autoblinda



Kosova & Rajoni

Përgjaket veriu i Kosovës, vritet polici, plagosen 2 të tjerë! 30 të armatosur ngujohen në manastirin e Banjkës! Mediat: Ekzekutohen 7 prej sulmuesve serbë

Tensionet janë rritur sërish në veri të Kosovës të banuar me shumicë serbe. Një pjesëtar i policisë së Kosovës është vrarë dhe 2 të tjetër janë plagosur si pasojë e një sulmi me armë në Zveçan. Mediat thonë se janë vrarë 7 terroristë serbë! ***4 serbë janë arrestuar***

- Flet kolegu i policit të vrarë në veri të Kosovës: Si kriminelët na sulmuan në mënyrë tinëzare
- Vrasja e policit në veri të Kosovës, xhaxhai i tij: Krenari është ta mbrosh çdo pëllëmbë të shtetit tonë, do e mbrojmë me çdo pikë të gjakut
- Kurti: Formacion i organizuar dhe i armatosur rëndë në Zveçan, kërkojnë luftë
- Dalin Fotot/ Ja formacioni i armatosur që vrau efektin në Kosovë, të veshur me veshje ushtarake e autoblinda
- Mesazhi i familjes së policit të vrarë: Afrim Bunjaku ra për atdheun
- Kurti: Grupi i armatosur është edhe rrotull shtëpive në Zveçan
- Reagon politika shqiptare/ Rama: Kriminelët të dalin përpara drejtësisë
- Mbyllet rruga që çon në fshatin Banjskë të Zveçanit
- Tensionet në veri të Kosovës, ndërkombëtarët: Dënojmë sulmin e tmerrshëm, autorët të dalin para drejtësisë! Palët t'i kthehen dialogut
- Vijojnë të shtënat në veri! VIDEO kur dëgjohen krismat
- Ndërkombëtarët: Dënojmë sulmin e tmerrshëm, autorët të dalin para drejtësisë
- Osmani ndërpret vizitën në New York: Sulmi u orkestrua nga Serbia
- EMRI/ Ky është polici i cili mbeti i vrarë në veri të Kosovës
- Polici i dytë që vritet në krye të detyrës në veri

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
24 Shtator, 07:45 | **Përditesimi: 24 Shtator, 17:02**

Share

KOSOVË- Tensionet janë rritur sërish në veri të Kosovës të banuar me shumicë serbe. Një pjesëtar i policisë së Kosovës është vrarë dhe 2 të tjetër janë plagosur si pasojë e një sulmi me armë në Zveçan.

Sipas ***mediave në Kosovë***, janë vrarë nga policia 7 terroristë serbë të cilët të armatosur rëndë ishin të ngujuar në Manastirin e Banjskës, ndërsa një tjetër është kapur nga Policia e Kosovës.



LEXO EDHE:
Vrasja e policit në veri të Kosovës/ Ministria e Jashtme gjermane dërgon diplomatin Sarrazin në Prishtinë: E dënojmë ashpër sulmin

Më herët, kryeministri Kurti bëri me dije se në Manasitur janë ngujuar 30 serbët e armatosur dhe shkëmbejnë zjarr me efektivët e policisë së Kosovës. Ndërkohë mediat e Kosovës bëjnë me dije se janë arrestuar 3 serbë.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:34 të mëngjesit të 24 shtatorit 2023 kur në hyrje të fshatit Banjskë, në urë janë vendosur dy mjete të rënda kamionë pa targa, duke e bllokuar lëvizjen. Autoritetet e Kosovës fajësojnë Serbinë për vrasjen dhe tregojnë si ndodhi.

> *"Grupet kriminale të mirë organizuara dhe të dirigjuara nga Beogradi, pas bllokimit të urës me mjete të rënda dhe pamundësimit të qasjes në fshatit Bajnskë, kanë sulmuar në pritë njësitë policore, ku për pasojë rreshteri i policisë së rendit Afrim Bunjaku është vrarë, dhe dy të tjerë janë plagosur gjendja e të cilëve është stabile" informoi rreth orës 14:00 ministri i Brendshëm Xhelal Sveçla0*

Autoritetet e Kosovës bëjnë me dije se është një grup prej 30 personash të uniformuar, të maskuar dhe të pajisur ushtarakisht me mjete të blinduara dhe armë të rënda të llojeve të ndryshme të cilët vijojnë të qëllojnë drejt policisë.

Kryeministri Albin Kurti në një konferencë për median mesditën e sotme deklaroi se sulmi mbi policinë vijon dhe tregoi foto të formacionit dhe armatimit që ata disponojnë

> *"Sulmet mbi policinë tonë janë duke vazhduar. Janë së paku 30 persona të armatosur rëndë që ndodhen nën rrethimin e forcave policore. I ftoj të dorëzohen. Formacion me profesionistë, ushtarak në Zveçan në dhe rrotull manastirit atje. Këto automjete janë pa targa, nuk i posedojnë serbët lokalë dhe askush që është civil në republikën tonë. Këto janë dy kamionët që kanë vendosur tek ura për të bllokuar qarkullimin. Shihni atje një person të maskuar që mban armë krahu që nuk është tipike për policinë."* tha kryeministri Kurti.

Burimi i sulmeve me armë zjarri është manastiri në Banjska të Zveçanit por policia e Kosovës kohë pas kohe janë duke u sulmuar me armë zjarri nga pozicione të ndryshme, nga grupet e organizuara dhe të armatosura rëndë.

> *Sulmi ka ardhur dhe po vazhdon akoma nga njësi profesionale të përgatitura dhe me një përbërje prej mbi 30 personave, të uniformuar, të maskuar dhe të pajisur ushtarakisht me mjete të blinduara dhe armë të rënda të llojeve të ndryshme.Burimi i sulmeve me armë zjarri është manastiri në Banjska të Zveçanit dhe përreth.*
>
> *Njësitë tona policore janë aktivizuar në terren, të njëjtat kohë pas kohe janë duke u sulmuar me armë zjarri nga pozicione të ndryshme, nga grupet e organizuara dhe të armatosura rëndë" deklaroi Sveçla.*

Kurti tha se grupi i armatosur ka ardhur të luftojë dhe bëri thirrje të dorëzohen.

> *"Kanë ardhur të luftojnë në Kosovë. Ne nuk duam luftë ne duam paqe. Dhe paqja do bëhet kur këta mbi 30 persona ti dorëzohen policisë. Kemi të bëjmë me banda të kontrabandës. Këto janë formacioni profesionistë, ushtarake a policore dhe u takon ekspertëve të vlerësojnë se ça janë këto uniforma"*

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani nga ana e saj e quajti sulm të "planifikuar, orkestruar dhe ekzekutuar nga bandat kriminale serbe".

Përfaqësitë diplomatike në Kosovë kanë dënuar sulmin duke bërë thirrje që autorët të vihen para drejtësisë. Mes tyre edhe Ambasadori i SHBA Jeffrey Hovenier, i cili tha se Policia e Kosovës ka përgjegjësi të plotë dhe legjitime për zbatimin e sundimit të ligjit në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Pika e kalimit kufitar në Bërnjak dhe e Jarinjes janë mbyllur ndërsa forcat e KFOR janë dislokuar në zonë.

Lajm ne përditësim...

1 / 27



Formacioni i armatosur

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:57

Policia e Kosovës e konfirmon vrasjen e tre sulmuesve në veri, arrestohen 4 serbë



Policia e Kosovës e ka konfirmuar vrasjen e tre sulmuesve në Banjskë të Zveçanit dhe arrestimin e një sulmuesi tjetër.

Përmes një komunikate për media, Policia ka thënë se i ka arrestuar katër persona tjerë të dyshuar, të cilat janë hasur nën posedim të radiolidhjeve, si dhe identifikimin e një sasie të konsiderueshme të armeve, municionit dhe pajisjeve të ndryshme.

Në orët e para të së dielës, si pasojë e sulmeve ndaj Policisë së Kosovës, është vrarë një zyrtar i këtij institucioni dhe dy të tjerë janë plagosur.

Më vonë edhe një zyrtar tjetër policor ka pësuar lëndime të lehta.

Policia ka thënë se situata vazhdon të jetë e tensionuar dhe se ende ka të shtëna me armë zjarri në atë pjesë.

G.MO/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:53

Sveçla: Lavdi Heroit Afrim Bunjaku! Zotohemi që lufta për rend, ligj e siguri në veri të Kosovës s'do ndalet

Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla ka bërë një reagim për policinë e vrarë në detyrë, Afrim Bunjaku. Sveçla thotë se luftën për ligj e siguri në veri të Kosovës nuk do të ndalet.

> *"Rreshter Afrim Bunjaku ra sot në krye të detyrës, në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës. Ne zotohemi, që lufta dhe përpjekja e Afrimit dhe gjithë pjesëtarëve të Policisë së Kosovës për rend, ligj dhe siguri në veri të vendit nuk do të ndalet.*
>
> *Lavdi Heroit Afrim Bunjaku!"- shkruan Sveçla.*

G.MO/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:39

'Të vdesësh për ATDHE është sikur të rilindësh përsëri', Kosova solidarizohet për policin e vrarë në veri të Kosovës

"Të vdesësh për ATDHE është sikur të rilindësh përsëri", me këtë parrullë Kosova solidarizohet për policin e vrarë në veri të Kosovës, Afrim Bunjakun.

Efektivi i policisë u vra sot nga një grup kriminelësh serb në Zveçan.

G.MO/Shqiptarja.com

Share

Ora 16:34

I veshur me uniformë të Njësisë Speciale Serbe 'Kobra', publikohet fotoja e njëri prej sulmuesve serbë të vrarë në veri të Kosovës

Është publikuar foto e njërit prej sulmuesve serb të vrarë nga policia e Kosovës, i cili duket me uniformë të Njësisë Speciale Serbe 'Kobra'. Sulmuesi serb dyshohet se është vrarë me snajper në kokë, ndërsa në krah ka edhe kallashnikovin.

Mediat e Kosovës bëjnë me dije se deri më tani dyshohet se janë vrarë 7 nga 30 sulmues serbë në veri të Kosovës. Paraprakisht mendohet se grupi i kriminelëve serbë përbëhet nga njësia speciale 'Kobra' dhe 'Brigada 72.

M.Q./Shqiptarja.com

Ora 16:31

Vrasja e policit në Zveçan, dyshohet se deri më tani janë vrarë 7 prej sulmuesve serbë! Grupi i armatosur përbëhet nga njësia speciale 'Kobra' dhe 'Brigada 72'

Mediat e Kosovës bëjnë me dije se deri më tani janë vrarë 7 nga 30 sulmues serbë në veri të Kosovës. Paraprakisht mendohet se grupi i kriminelëve serbë përbëhet nga njësia speciale 'Kobra' dhe 'Brigada 72. Ende nuk ka një konfirmim nga policia e Kosovës për këto të dhëna të fundit.

G.MO/Shqiptarja.com

Ora 16:14

Vrasja e policit në Zveçan, mediat: Shkon në 3 numri i sulmuesve serbë të vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit

Ka shkuar në tre numri i sulmuesve të vrarë në Basnjkë të Zveçanit.

Media Klankosova.tv raporton se edhe është gjetur trupi i pajetë i një tjetër sulmuesi serb.

Deri më tani, policia ka konfirmuar vetëm një vrasje.

Kujtojmë se në orët e hershme të mëngjesit, një polic i Kosovës ka mbetur i vrarë dhe një tjetër i plagosur.

M.Q./Shqiptarja.com

Ora 16:11

Vrasja e policit në veri të Kosovës, xhaxhai i tij: Krenari është ta mbrosh çdo pëllëmbë të shtetit tonë, do e mbrojmë me çdo pikë të gjakut

Gani Bunjaku, xhaxhai i policit Afrim Bunjaku që u vra në orët e para të mëngjesit në veri të Kosovës, ka kërkuar që deklarata e djalit të tij, drejtuar kryeministrit Albin Kurti, të mos keqinterpretohet, raporton Ekonomia Online.

Ai e ka quajtur hero policin e ndjerë, Afrim Bunjaku, për të cilin tha se e ka ndier veten krenar që i ka shërbyer vendit të tij. Bunjaku falenderoi institucionet për kujdesin dhe ndihmën ndaj familjes së tyre.

> *"Falenderoj shtetin se është interesuar me na 'zvogëlu dhimbjen' dhe me na ndihmu në çdo mënyrë. Jam falenderues ndaj gjithë atyre që vijnë dhe na ngushëllojnë", tha fillimisht Bunjaku.*

Ai kërkoi që deklaratat të mos keqinterpretohen, teksa e quajti krenari mbrojtjen e sovranitetit.

> *"E pashë se i intervistuari ka qenë djali im, e pashë se shumë njerëz po e keqinterpretojnë. Le të merret për bazë statusi që ka bërë në Facebook. Krenari është ta mbrosh çdo pëllëmbë të këtij shteti tonë që me vonesë e kemi fituar dhe ta mbrojmë me çdo pikë të gjakut", tha Gani Bunjaku.*

Ai ka treguar edhe për bisedat që ka pasur me të ndjerin, Afrim Bunjakun, për të cilin tha se ka shkuar me krenari në shërbim të atdheut.

> *"Jam xhaxhai më i vogël i tij. Shpeshherë kam pas kontakte me të kur ka shkuar dhe kam biseduar me të dhe ka thënë se 'krenar po e ndiej vetën që po shkoj atje dhe po i shërbej vendit tim' dhe me vullnet ka shkuar dhe faktikisht u vërtetua se edhe Zoti ka dashtë që atë ta shpërblejë me titullin e heroit të Kombit dhe do të jetë hero i Kombit", tha Bunjaku./koha.net*

S.S/Shqiptarja.com

Ora 16:09

Ambasadori amerikan pas takimit me Kurtin: Jemi thellësisht të shqetësuar për situatën

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier ka folur pas takimit me kryeministrin e Kosovës Albin Kurti.

Ai ka thënë se janë thellësisht të shqetësuar për situatën.

> *"Nuk mund të themi diçka më shumë se ajo që e kemi thënë", ka thënë ai pas takimit.*

G.MO/Shqiptarja.com

Ora 16:09

Sulmi në Veri, BBC: Policia e Kosovës rrethon 30 sulmuesit të armatosur brenda Manastirit

Forcat e policisë së Kosovës kanë rrethuar të paktën 30 persona të armatosur disa orë pasi një polic u qëllua për vdekje në Kosovë sot.

Kryeministri Albin Kurti tha se grupi i sulmuesve ndodhet në një manastir në fshatin verior të Banjskës ndërsa u kërkoi atyre të dorëzoheshin.

Media britanike BBC shkruan se Kurti ka akuzuar Serbinë se mbështet atë që ai e quajti një "sulm terrorist" që gjithashtu solli plagosjen e një oficeri tjetër kosovar.

'Tensionet janë rritur në Kosovë, pas përleshjeve të dhunshme pas zgjedhjeve të diskutueshme lokale në maj. Bisedimet politike të ndërmjetësuara nga BE, të dizajnuara për të stabilizuar situatën, kanë ngecur.

Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008, por Serbia – së bashku me aleatët kryesorë të Beogradit, Kinën dhe Rusinë – nuk e njohin atë. Shumë serbë e konsiderojnë atë vendlindjen e kombit të tyre. Por nga 1.8 milionë njerëz që jetojnë në Kosovë, 92% janë shqiptarë etnikë dhe vetëm 6% janë serbë etnikë.

Të shtënat e së dielës ndodhën rreth orës 03:00, pasi policia tha se ata arritën në Banjska, afër kufirit me Serbinë, ku ishte raportuar një bllokadë. Oficerët u sulmuan nga disa pozicione të ndryshme me "një arsenal armësh zjarri, duke përfshirë granata dore", shkruan BBC.

"Ne mund të shohim njerëz të armatosur me uniforma…ata po qëllojnë mbi ne dhe ne po qëllojmë", tha zyrtari i policisë së Kosovës Veton Elshan për agjencinë e lajmeve AFP përmes telefonit nga Banjska.

Kisha Ortodokse Serbe tha se persona të armatosur kishin sulmuar një manastir në fshat, që ndodhet në Leposaviq, ku po qëndronin pelegrinët nga qyteti verior serb i Novi Sadit.

M.Q./Shqiptarja.com

Ora 15:37

Tensionet në veri të Kosovës, shkon në dy numri i sulmuesve serb të vrarë, 3 serbë të arrestuar në Zveçan

Vritet një tjetër sulmues serb në Zveçan duke thelluar në 2 numrin e viktimave serbë nga shkëmbimet me armë zjarri në Manastir.

Burime të Klankosova.tv bëjnë të ditur janë gjetur edhe trupat e pajetë të dy të vrarëve.

Deri më tani, policia ka konfirmuar vrasjen e njërit prej sulmuesve. ndërkohë janë arrestuar 3 serbë në Zveçan

Kujtojmë se në orët e para të mëngjesit, një pjesëtar i Policisë së Kosovës ka mbetur i vrarë, ndërsa 2 të tjerë janë plagosur.

G.MO/Shqiptarja.com

Ora 15:21

Tensione në veri të Kosovës/ Gërvalla reagon ashpër ndaj Borrell: E turpshme, asnjë fjalë kundër terroristëve që vrasin policët

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla ka reaguar ashpër ndaj Përfaqësuesit të BE-së, Josep Borrell për deklaratën e tij lidhur me sulmin e armatosur ndaj policisë në veri të vendit, ku u vra 1 polic dhe 2 të tjerë u plagosën.

Gërvalla tha se asnjë fjalë e Borrell nuk ishte në mbështetje të Policisë së Kosovës dhe as kundër terroristëve.

> *"Zoti Borrell, vërtet? Terroristët vrasin policët – dhe ju thërrisni "të gjithë aktorët"? Asnjë fjalë mbështetje për policinë? As kundër terroristëve? A i referuat edhe sulmeve terroriste në Spanjë si "armiqësore"?, ka shkruar Gërvalla në platformën "X".*

Ajo e ka quajtur këtë reagim të turpshëm duke pyetur se si "mund ta tolerojnë më këtë cinizëm anëtarët e BE-së?".

S.S/Shqiptarja.com

Ora 15:16

Flet kolegu i policit të vrarë në veri të Kosovës: Si kriminelët na sulmuan në mënyrë tinëzare

Fahri Shala, pjesëtar i Policisë së Kosovës në një reagim në rrjetet sociale ka treguar se si ka ndodhur sulmi i sotshëm në veri të Kosovës, ku ishte bashkë me policin që u vra, Afrim Bunjaku.

Shala shkruan se ata janë sulmuar në mënyrë tinëzare nga kriminelët ndërkohë që ishin duke kryer detyrat zyrtare dhe ligjore.

> *"Sot në orët e para të mëngjesit derisa ishim duke i kryer detyrat zyrtare dhe ligjore së bashku me Rreshterin tim Afrim Bunjaku, nga kriminelet në mënyrë tinëzare u sulmuam dhe në këtë rast u vra Rreshteri Afrim Bunjaku.*
>
> *Me trishtim të madh dhe zemër të thyer dëshirojmë të përshkruajmë ndjenjat e mia të thella të dhimbjes dhe humbjes për kolegun tonë të nderuar Rreshter Afrim Bunjaku. Ai la pas një ndikim të thellë jo vetëm në jetën tonë profesionale, por edhe në jetën tonë personale.*
>
> *Kolegu ynë Rreshter Afrim Bunjaku ishte një njeri i jashtëzakonshëm, me një karakter të fortë dhe një përkushtim të paepur ndaj detyrës së tij. Ai punoi me përkushtim në detyrën zyrtare dhe solli një ndryshim të vërtetë në komunitetin tonë dhe në jetën e të tjerëve.*

> *Kujtimet me të janë të pafund, nga momentet e gëzueshme të bashkëpunimit profesional deri te kujtimet personale të ndarë me të gjatë rrugës sonë të përbashkët. Ai ishte një mik i vërtetë dhe një koleg i shkëlqyeshëm.*
>
> *Vrasja e tij është një humbje e madhe për familjen, kolegët dhe komunitetin në përgjithësi. Ne shprehim solidaritetin tonë me familjen e tij dhe ndjenjat tona më të ngrohta të ngushëllimeve.*
>
> *Ne besojmë në drejtësi dhe shpresojmë që ata përgjegjës për këtë akt të tmerrshëm do të gjenden dhe do të përballojnë ligjin. Kujtimi i kolegut tim Rreshter Afrim Bunjaku do të vazhdojë të jetë burim inspirimi për të gjithë ne që ndjejmë përgjegjësinë për të vazhduar detyrën tonë zyrtare me integritet dhe përkushtim.*
>
> *Le të kujtojmë dhe të nderojmë gjithmonë kontributin e tij të jashtëzakonshëm në jetën tonë dhe në detyrën tonë zyrtare. Ai do të mungojë shumë dhe kujtimi i tij do të mbetet gjallë përjetësisht në zemrat tona.*
>
> *Nuk mund te besoj se sot do te ishte ndarja dhe bisedat e fundit!*
>
> *Me respekt dhe dhimbje të thella! Fahri Shala, pjesëtar i Policisë së Kosovës!'- shkruan Shala.*

M.Q./Shqiptarja.com

Ora 14:50

Tensionet në veri të Kosovës, polica: Ekzekutohet një nga sulmuesit gjatë shkëmbimit të zjarrit

Policia e Kosovës thotë se një prej anëtarëve të grupit të armatosur në Zveçan është vrarë si pasojë e shkëmbimit të zjarrit. Grupi i armatosur me mbi 30 persona janë futur në manastirin në Zveçan dhe po sulmojnë policinë e Kosovës e cila i ka rrethuar. Ata janë të armatosur rëndë.

> *"Njësitet policore konform situatës dhe rrezikut të shfaqur nga sulmet sporadike të grupeve kriminale, në vetëmbrojtje të tyre dhe të qytetarëve të asaj zone, janë detyruar t'iu kundërpërgjigjen grupeve kriminale, ku referuar informacioneve të deritanishme, një nga sulmuesit është vrarë", ka konfirmuar Policia e Kosovës.*
>
> *"Situata në Veri të vendit, konkretisht në zonën e fshatit Banjska vazhdon të jetë e tensionuar, grupet kriminale kohë pas kohe po sulmojnë me armë zjarri njësitet policore në teren, të cilat edhe përkundër sulmeve ndaj tyre po vazhdojnë angazhimin duke krijuar perimetër të sigurisë, në interes të qetësimit të situatës, ofrimit të sigurisë dhe sundimit të rendit dhe ligjit në Kosovës", thuhet në reagim.*

Sulmuesit janë të pajisur me armë të rënda.

> *"Sulmuesit profesional në numër të konsiderueshëm, të maskuar e të uniformuar me uniforma të ndryshme, të armatosur me armë të rënda, granata, mjete ushtarake (zolla), disa mjete të blinduara, po shfrytëzojnë hapësira dhe objekte të ndryshme, private, përfshirë në dhe përreth manastirit në Banjska, për të kryer lëvizje, strehim dhe pozicionim për gjuajtje me armë zjarri ndaj njësiteve policore të PK-së", thuhet më tutje.*
>
> *"Referuar situatës dhe rrethanave të krijuara, Policia e Kosovës për shkaqe sigurie ka mbyllur për qarkullim kufitar dy vendkalimet kufitare në veri (Jarinje dhe Bërnjak), andaj fton të gjithë qytetarët që të shfrytëzojnë pikat tjera kufitare për qarkullim si dhe të shmangun daljet dhe lëvizjet e tyre në atë rajon/zone", theksohet në komunikatë.*
>
> *"Bashkëpunimi dhe koordinimi i Policisë së Kosovës me institucionet kompetente vendore dhe ndërkombëtare po vazhdon, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike si dhe sjelljes para organeve të drejtësisë së kryerësve të sulmeve të vazhdueshme ndaj zyrtarëve policorë dhe njëherit fton ata që të dorëzohen para organeve të rendit", përfundon njoftimi.*

Sl.E./Shqiptarja.com

Ora 14:24

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Vuçiç njofton konferencë të jashtëzakonshme

Pas vrasjes së policit në veri të Kosovës, presidenti serb Aleksandër Vuçiç pritet të mbajë një konferencë të jashtëzakonshme pasdite.

> *"Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, do t'i ekspozojë të gjitha gënjeshtrat dhe shakatë e Albin Kurtit, krijuesit të kaosit dhe ferrit në Kosovë e Metohi", ka thënë Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.*

Sl.E./Shqiptarja.com

Ora 13:59

Sveçla: Grupet e armatosura të dirigjuara nga Beogradi! Burimi i sulmit manastiri në Banjska! Po sulmohemi nga pozicione të ndryshme

Ministri I Brendshëm Xhelal Sveçla i quan 'grupe kriminale të mirë organizuara dhe të dirigjuara nga Beogradi" ata që sulmuan sot policinë e Kosovës ku mbeti I vrarë një polic dhe 2 janë plagosur.

> *"Grupet kriminale të mirë organizuara dhe të dirigjuara nga Beogradi, pas bllokimit të urës me mjete të rënda dhe pamundësimit të qasjes në fshatit Bajnskë, kanë sulmuar në pritë njësitë policore, ku për pasojë rreshteri i policisë së rendit Afrim Bunjaku është vrarë, dhe dy të tjerë janë plagosur gjendja e të cilëve është stabile" shkruan ministri në një postim në facebook*

Më tej ai thotë se burimi i sulmeve me armë zjarri është manastiri në Banjska të Zveçanit dhe përreth.

> *"Sulmi ka ardhur dhe po vazhdon akoma nga njësi profesionale të përgatitura dhe me një përbërje prej mbi 30 personave, të uniformuar, të maskuar dhe të pajisur ushtarakisht me mjete të blinduara dhe armë të rënda të llojeve të ndryshme. Burimi i sulmeve me armë zjarri është manastiri në Banjska të Zveçanit dhe përreth.*
>
> *Njësitë tona policore janë aktivizuar në terren, të njëjtat kohë pas kohe janë duke u sulmuar me armë zjarri nga pozicione të ndryshme, nga grupet e organizuara dhe të armatosura rëndë"*

Ai I bën thirrje të dorëzohen

> *Një numër i tyre janë të barrikaduar brenda manastirit në Banjska edhe sipas deklarimeve zyrtare të Dioqezës Rashkë-Prizren. Këta terroristë janë të rrethuar nga njësitë policore dhe është koha e fundit që të dorëzohen.*

Gjithashtu shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjarëve të Rreshterit Afrim Bunjaku dhe të gjithë pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.Në këto momente të vështira qëndrojmë bashkë dhe fuqishëm pranë tyre.

S.G/Shqiptarja.com

Ora 13:47

Vrasja e policit në veri të Kosovës, mbyllet edhe pikëkalimi kufitar Jarinje

Sipas faqes së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, është mbyllur edhe pikëkalimi i dytë kufitar mes Kosovës dhe Serbisë, Jarinje.

Në mëngjesin e së dielës, është mbyllur fillimisht pika kufitare Bërnjak.

Këto dy pika kufitare janë mbyllur disa herë në të kaluarën, në kohën e rritjes së tensioneve mes Kosovës dhe Serbisë.

Sl.E./Shqiptarja.com

Ora 13:44

Harta/ Ja ku ndodhi vrasja e policit në veri të Kosovës

Një zyrtar i Policisë së Kosovës është vrarë të dielën në veri të Kosovës. Policia ka thënë se është sulmuar në fshatin Banjskë të Zveçanit, ku një zyrtar tjetër është plagosur dhe një tjetër është lënduar. Autoritetet e Kosovës e kanë fajësuar Serbinë për vrasjen.



S.G/Shqiptarja.com

Ora 13:35

Kryetari i Parlamentit serb fajëson Kurtin: Përgjegjës për dhunën, është nxituar duke fajësuar serbët

Kryetari i Parlamentit të Serbisë, Vlladimir Orlliç ka thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti është përgjegjës për çfarëdolloj dhune, dhe se është ngutur për t'i fajësuar serbët për zhvillimet në Banjskë të Zveçanit.

> *"Gjithçka që ai [Kurti] ka bërë në muajt e fundit, me terrorin brutal që e ka kryer kundër popullit serb, e ka bërë sepse ka dashur përshkallëzim të hapur, dhe sepse ka dashur të shkaktojë dhunë", është cituar të ketë thënë ai.*

Kurti deklaroi se "krimi i organizuar me mbështetje politike, financiare dhe logjistike nga Beogradi zyrtar po e sulmon shtetin e Kosovës."

M.T/Shqiptarja.com

Ora 13:34

Grupi i armatosur në Zvecan pjesë e 'Wagner'? Zv/drejtori i Policisë: Kemi pasur informacione se po lëvizin në Kosovë, asgjë e konfirmuar

Zv/drejtori i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti deklaroi se autoritetet kanë pasur informacione mbi lëvizjen në kufi me Serbinë të pjesëtarëve të grupit mercenar 'Wagner', që aludohen se janë pjesë e sulmit të sotëm ndaj forcave policore në veri.

Në një konferencë të përbashkët me Kurtin, Hoti tha se kishin pasur dhe informacione se mund të kishte sulme, por asgjë nuk është e vërtetuar deri më tani.

> *"Kemi pasur informacione se po lëviznin pjesëtarë të grupit Wagner, dhe që mund të vinin të sulmonin, por asgjë të konfirmuar për sot. Jemi duke u koordinuar me KFOR-in. Në Prokurori duhen fakte kur deklaron diçka", tha ai.*

M.T/Shqiptarja.com

Ora 13:04

Dalin Fotot/ Ja formacioni i armatosur që vrau efektin në Kosovë, të veshur me veshje ushtarake e autoblinda



Pas sulmit me armë ndaj Policisë së Kosovës në Zveçan, ku një polic humbi jetën ndërsa 1 tjetër u plagos, kryeministri Albin Kurti ka publikuar fotot e autorëve.

Teksa u ka bërë thirrje autorëve të dorëzohen, Kurti ka zbuluar se grupi prej 30 personash që ka sulmuar makinën e policisë, ka hyrë nga Serbia.

Sipas tij, autorët janë të armatosur dhe lëvizin me mjete autoblind pa targa.

Në pamjet e publikuara, autorët shihen me armë në duar dhe janë veshur me uniforma ushtarake e maska të zeza.

M.T/Shqiptarja.com

Ora 13:03

Vrasja e policit në veri, Kurti: Grupi i armatosur nuk është vetëm brenda në manastir, janë edhe rrotull shtëpive në Zveçan

Kryeministri Albin Kurti thotë se nuk ka dijeni ca ka brenda në manastir, ku janë vendosur grupi me mbi 30 persona në Zveçan që kanë qëlluar ndaj makinës së policisë, ku vdiq një polic. Kurti tha se me shumë gjasa personat e armatosur janë edhe rreth e rrotull shtëpive në Zveçan.

> *Nuk e dimë ca ka brenda në manastir. Këto foto janë ca kemi parë jashtë, këta persona me shumë gjasa janë edhe në shtëpitë rrotull, nuk janë të gjithë në manastir.*

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 12:47

Vrasja e policit në veri, Kurti: Grupi i armatosur ka ardhur të luftojë në Kosovë, paqe do ketë vetëm pasi t'i dorëzohen policisë



Kryeministri Albin Kurti thotë se grupi prej 30 personash që ka sulmuar makinën e policisë, ku mbeti një efektiv i vrarë, ka ardhur të luftojë në Kosovë. Kurti thotë se duan paqe, por do arrihet vetëm nëse ata i dorëzohen policisë, pasi janë të rrethuar në një manastir në Zveçan.

> *"Kanë ardhur të luftojnë në Kosovë. Ne nuk duam luftë ne duam paqe. Dhe paqja do bëhet kur këta mbi 30 persona ti dorëzohen policisë. Kemi të bëjmë me banda të kontrabandës. Këto janë formacioni profesionistë, ushtarake a policore dhe u takon ekspertëve të vlerësojnë se ça janë këto uniforma", tha Kurti.*

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 12:40

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Kurti: Formacion i organizuar dhe i armatosur rëndë në Zveçan, kërkojnë luftë

Pas vrasjes se policit në Kosovë, Albin Kurti thotë se grupi prej 30 personash është një formacion profesional. Kurti thotë se janë të armatosur rëndë, si edhe kanë autoblind pa targa. Ai tha në konferencë se kanë ardhur për të luftuar e destabilizuar dhe u bën thirrje për t'u dorëzuar.

> *"Bëhet fjalë për formacion të organizuar, është i armatosur. Janë formacion profesional, janë mbi 30 individë që ka hyrë në Kosovë dhe perimetri është i vendosur rrotull vendndodhjes së tyre. Pak para orës 3 të mëngjesit, ku ri ka pa policia dy kamionë në urën në Zvecan, me bateri ndriçimi kanë parë që dera e njërit kamion është e hapur, ndërkaq një kamion tjetër ka diçka prej dritave ndezur. Përveçse ka bllokuar qarkullimin, ka qenë një lloj përpjekje për të krijuar përshtypjen se bëhet fjalë për kontrabandë. Me këtë rast kanë ardhur nga zvecan edhe 10 automjete me polic kur e kanë pësuar sulmin. Afrim bonjaku është rreshter i policisë së rendit. Ky është sulm kriminal dhe terrorist. Ka qenë situatë. Kanë ardhur të luftojnë, të destabilizojnë. Kërkoj të dorëzohen", tha Kurti.*

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 12:29

Vrasja e policit në Kosovë, Kurti: 30 persona të armatosur rëndë janë rrethuar nga policia në Zveçan, po qëllojnë drejt efektivëve! Të dorëzohen

RTK 3
QEVERIA E
VLADA
GOVERNMENT

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka reaguar pas mbledhjes së Këshillit të Sigurimit. Në konferencë për mediat, Kurti thotë se 30 persona të armatosur rëndë janë rrethuar nga policia në Aveçan dhe janë autorët që vranë policinë. Kurti tha s epo vijojnë sulmet ndaj policisë së Kosovës, ndërsa u bëri thirrje që të dorëzohen.

> *Sulmet mbi policinë tonë janë duke vazhduar. Janë së paku 30 persona të armatosur rëndë që ndodhen nën rrethimin e forcave policore. I ftoj të dorëzohen. Formacion me profesionistë, ushtarak në Zveçan në dhe rrotull manastirit atje. Këto automjete janë pa targa, nuk i posedojnë serbët lokalë dhe askush që është civil në republikën tonë. Këto janë dy kamionët që kanë vendosur tek ura për të bllokuar qarkullimin. Shihni atje një person të maskuar që mban armë krahu që nuk është tipike për policinë.*

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 12:22

Vrasja e policit në veri të Kosovës, mbyllet rruga që çon në fshatin Banjskë të Zveçanit

Policia e Kosovës e ka bllokuar rrugën kryesore që të çon në fshatin Banjskë (majtas) prej rrugës magjistrale Prishtinë – Rashkë.

Sipas reporterëve të Radios Evropa e Lirë, trafiku në rrugën magjistrale është i hapur dhe nuk ka shumë njerëz.

Ata kanë thënë se prej këtij udhëkryqi – që njihet si i Ballabanit dhe i cili të çon në Banjskë – po dëgjohen të shtëna me armë zjarri.

Në fshatin tjetër të Zveçanit, Rudarë, janë parë njësitet speciale të Policisë së Kosovës.

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 12:18

Vrasja e policit në veri, reagon familja: Afrim Bunjaku vdiq duke mbrojtur integritetit territorial të Kosovës! Kush vdes për atdhe, rilind përsëri



Polici Afrim Bunjaku vdiq në krye të detyrës në veri të Kosovës, ndërsa u sulma me armë nga persona të armatosur të cilët dyshohet se janë futur nga territori i Serbisë. Familja Bunjaku ka reaguar për këtë ngjarje të rëndë, duke thënë se polici vdiq në krye të detyrës duke mbrojtur integritetin territorial të Kosovës, të cilën e bëri me krenari deri në frymën e fundit.

> *"TË VDESËSH PËR ATDHE ËSHTË SIKUR TË RILINDËSH PËRSËRI. Të nderuar miq, të dashur familjarë, Sot, në orët e hershme të mëngjesit erdhi një lajm i kobshëm për familjen tonë Bunjaku nga Samdrexha e Vushtrrisë.*
>
> *Familjari jonë *AFRIM BUNJAKU* , Rreshter në policinë e Kosovës është vrarë derisa ndodhej në detyrë, në veriun e Kosovës, në mbrojtje të integritetit territorial dhe sovranitetit të vendit gjë të cilën e bëri me nder e krenari deri në frymën e fundit. E pikëlluar familja Bunjaku nga Samadrexha e Vushtrrisë", thuhet në njoftim.*

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 12:10

Ministri i Shëndetësisë së Kosovës: Gjendja e policit të plagosur jashtë rrezikut për jetën

Gjendja e policit të plagosur në veri të Kosovës është jashtë rrezikut për jetë, ka thënë ministri i Shëndetësisë në Kosovë, Arben Vitia, pas vizitës që ia ka bërë zyrtarit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Pas vrasjes së ka ndodhur në Banjskë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, e ka ngritur gjendjen e gatishmërisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe spitalet e përgjithshme, veçanërisht atë të Mitrovicës dhe Vushtrrisë.

SI.E./Shqiptarja.com

Ora 12:09

Vijojnë të shtënat në veri të Kosovës! VIDEO teksa dëgjohen krismat e armës

Të shtëna me armë po vazhdojnë të dëgjohen në veri të vendit.

Në një video të siguruar nga Klankosova.tv dëgjohen të shtëna të cilat dyshohet se nuk janë e një kalibri të vogël.

Kujtojmë se një polic ka mbetur i vrarë në orët e para të mëngjesit në veri të vendit.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 11:19

Vrasja e policit në veri të Kosovës, gazetari për Report Tv: Përfundoi mbledhja e Këshillit të Sigurisë! Të armatosurit janë ende në manastir të rrethuar nga policia

Gazetari nga Kosova, Velhar Isufi ka folur në Report Tv pas situatës së tensionuar në veri, ku një polic ka mbetur i vrarë. Gazetari thotë se ka përfunduar mbledhja e Këshillit të Sigurisë së thirrur nga Albin Kurti.

Ai thekson se personat e armatosur kanë qenë të maskuar dhe kanë ardhur nga territori i Serbisë në Kosovë dhe kanë qëlluar ndaj makinës së policëve. Gazetari thotë se personat e armatosur janë ende brenda manastirit të Banjskë të Zveçanit dhe janë rrethuar nga policia e Kosovës, ndërsa ka pasur edhe shkëmbim zjarri mes tyre.

> *“Sa ka përfunduar mbledhja e këshillit të sigurisë. Shpresojmë se do dalin detaje të reja, ku një polic ka mbetur i vdekur një polic dhe është plagosur një oficer tjetër që është në gjendje stabël, i është larguar predha ku ka qenë i plagosur në dorë. Situata në atë pjesë mbetet e tensionuar. Policia ka mbyllur rrugën që të çon nga Mitrovica e veriut në Zveçan. Dyshohet se persona të veshur me bluza jeshile dhe të armatosur kanë hyrë brenda territorit të republikës së Kosovës dhe janë pozicionuar në manastir. Janë duke qëndruar aktualisht, janë rrethuar nga policia dhe personat e armatosur kanë qëlluar herë pas here. Janë rritur forcat e policisë në atë zonë, KFOR dhe pritet se si do të veprohet më tutje. Policia e Kosovës i ka marrë të gjitha masat”, tha gazetari për Report Tv.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 10:22

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Kurti viziton njërin nga efektivët e plagosur në spital! Mbledh Këshillin e Sigurisë

Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, ka vizituar njërin nga policët që mbeti i plagosur në orët e para të mëngjesit në veri të Kosovës.

Kurti shprehet se Alban Rashiti, i cili u plagos bashkë me një tjetër ndodhet në Klinikën Kirurgjike të QKUK-së në gjendje të mirë shëndetësore.

Kreu i qeverisë bëri me dije gjithashtu se nga ora 10:00, do të mblidhet Këshilli i Sigurisë, shkaku i zhvillimeve në veri ku edhe u vra rreshteri policor Afrim Bunjaku.

> *“Operacioni i heqjes së predhës nga krahërori i majtë i policit Alban Rashiti është kryer me sukses sot në mëngjes. Predha ishte e një granate dore që e hodhën kriminelët e orkestruar nga Serbia në drejtim të policisë së Kosovës gjatë sulmit të tyre terrorist afër urës në Banjskë të Zveçanit. Gjatë vizitës në Klinikën Kirurgjike të QKUK-së takova edhe familjen e Albanit e cila erdhi nga Velekinca e Gjilanit. Polici i plagosur Alban Rashiti do të lirohet sot nga spitali.Tani në ora 10:00 kemi mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës”, ka shkruar Kurti.*

M.T/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:29

Publikohen pamjet nga shtëpia e policit të vrarë në veri

Një ambulancë dhe një makinë policie qëndrojnë para shtëpisë së Afrim Bunjakut, policit që mbeti i vrarë në Banjskë të Zveçanit, në veri.

Rreshteri u vra si pasojë e një sulmi nga persona të armatosur.

M.T/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:28

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Presidenca: Persona të maskuar dje me automjete të blinduara janë futur nga Serbia 15 km brenda territorit tonë

Shefi i Stafit në Kabinetin e presidentes Vjosa Osmani, Blerim Vela, ka thënë se persona të maskuar të Serbisë, të cilët kanë qenë me automjete të blinduara janë futur 15 kilometra brenda territorit të Kosovës.

Vela tha se presidenti serb, Alekasandar Vuçiç “i është drejtuar një agresioni të paparë ndaj Kosovës. Ai do të dështojë”.

Kujtojmë se mëngjesin e sotëm, një polici i Kosovës pas sulmit me armë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:21

VIDEO/ Vrasja e efektivit në veri të Kosovës, policia dhe KFOR shihen në afërsi të Banjskës

Forca të shtuara të Policisë së Kosovës bashkë me KFOR-in janë parë në rrugën Mitrovicë – Leposaviç, përkatësisht në afërsi të Banjskës. Prania e tyre vjen pas vrasjes së efektivit Afrim Bunjaku, ndërsa sipas policisë ende po vijon shkëmbimi i zjarrit mes personave të armatosur dhe policisë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:12

Vrasja e Policit në Kosovë, mbyllet pika kufitare në Bërnjak

Pas vrasjes së policit në veri në komunën e Leposaviçit, është mbyllur pika kufitare në Bërnjak për hyrje nga Serbia.

Mbyllja e kësaj pike vjen pas rritjes së tensioneve në veri të vendit, ku në orët e mëngjesit u vra një polic i Kosovës dhe u plagos një tjetër nga grupe kriminale.

Në lidhje me këtë, kanë reaguar të gjithë liderët e shtetit, ku e kanë dënuar si akt dhe kanë bërë thirrje që kryesit e kësaj vepre të dalin para drejtësisë.

M.T/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:02

Del FOTO, kush është polici që u vra në veri të Kosovës

Ky është Afrim Bunjaku, polici i cili mbeti i vrarë në veri të Kosovës, pas një sulmi nga persona të armatosur. Afrim Bunjaku, polic i Rendit me gradën rreshter. Ai mbeti i vrarë pas sulmit në Leposaviç, ku persona të armatosur dhe të maskuar kanë bllokuar rrugën me dy kamionë dhe kanë qëlluar në drejtim të makinës së policisë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:52

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Haradinaj: Serbia të heqë dorë nga veprimet destabilizuese e luftënxitëse

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj ka reaguar pas vrasjes së policit në veri të Kosovës.

Përmes një postim në Facebook. Haradinaj ka shkruar se sulmi ndaj efektivëve të policisë është goditje e rëndë mbi paqen dhe stabilitetin jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon.

> *“Ky sulm terrorist është goditje e rëndë mbi paqen dhe stabilitetin jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon! Beogradi duhet që urgjentisht të heqë dorë nga veprimet e veta destabilizuese e luftënxitëse me pasoja të paparashikueshme jo vetëm për Kosovën por edhe për Serbinë. Është investuar shumë për paqen dhe askush nuk do të lejohet ta*

> *rrezikojë atë. Ftoj organet tona të rendit për bashkërendim të veprimeve me KFOR dhe aleatët tanë të sigurisë të prirë nga Amerika, dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për ta zbardhur gjithë këtë situatë dhe për të sjellë para drejtësisë, përgjegjësit e këtij akti. Rendi dhe ligji s'ka alternativë. Ngushëllime për familjen e policit që humbi jetën dhe shërim të shpejtë për policin e plagosur!", ka shkruar Haradinaj.*

M.T/Shqiptarja.com

Share

Ora 08:50

Vrasja e Policit në Kosovë, autorët e armatosur janë futur në një manastir dhe po shkëmbejnë zjarr me patrullat

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në veri të Kosovës, ku një polic ka mbetur i vrarë pas një sulmi me armë nga person atë maskuar. Policia e Kosovës thotë se janë qëlluar nga grupe të armatosura në vende të ndryshme, ndërsa ende po shkëmbejnë zjarr.

Sipas Klan Kosovës, personat e armatosur që vranë policin janë futur në një manastir në Banjska të Leposaviçit, dhe po shkëmbehet zjarr mes tyre dhe policisë.



Zona ku ka ndodhur sulmi

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:41

Vrasja e policit në Kosovë, Konjufca: Sulm i strukturave të drejtuara nga Serbia! SHBA dhe BE të dënojnë këtë agresion

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka reaguar pas vrasjes së policit në veri të Kosovës. Konjufca tha se ky është një sulm i drejtpërdrejt ndaj rendit kushtetues të Kosovës, ndërsa i bën thirrje SHBA e BE që të dënojnë agresionin.

> *"Prandaj, i kërkojmë fuqishëm faktorit ndërkombëtar, veçanërisht BE-së dhe SHBA-së që ta dënojnë Serbinë për këtë agresion të hapur kundrejt Kosovës".*
>
> *"Në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së policit të vrarë, ndërsa policit të plagosur shërim sa më të shpejtë", tha Konjufca, transmeton Klankosova.tv.*

Ai kërkon që autorët e këtij krimi urgjentisht të sillen para drejtësisë.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:31

Vrasja e policit në Kosovë, reagon policia: Shkuam menjëherë në vendngjarje, jemi sulmuar nga grupe të armatosura

Policia e Kosovës ka reaguar për vrasjen e policit në veri në komunën e Leposaviçit, ku thotë se menjëherë pasi kanë marrë informacion se rruga është bllokuar nga dy kamionë, janë nisur drejt vendit të ngjarjes. Në reagimin zyrtar thuhet se grupi i policëve është sulmuar nga grupe të armatosura në disa vendetë ndryshme.

> *Policia e Kosovës (PK) në vazhdën e realizmit të detyrave dhe autorizimeve të saja kushtetuese dhe ligjore, sipas detyrës zyrtare ka të angazhuara njësi patrulluese në nivel vendi, me qëllim të kryerjes së detyrave policore në interes të ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike si dhe ofrimit të sigurisë ndaj të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim.*
>
> *Gjatë realizimit të detyrave policore, sot rreth orës 02:34 në Mitrovicë Veri, njësia për ndërhyrje të shpejtë e policisë kufitare ka vërejtur se në hyrje të fshatit Bajnskë, në urë janë vendosur dy mjetet të rënda kamion (pa targa) dhe hyrja në këtë fshat përmes urës nuk mund të bëhet, pasi e njëjta është bllokuar.*
>
> *Njësitë e rendit të Stacionit Policor Zveqan, pas pranimit të informacionit i janë përgjigjur rastit dhe janë nisur me tri njësi në drejtim të lokacionit dhe posa kanë mbërri në afërsi të vendit ku është raportuar bllokada, njësitë policore kanë hasur në rezistencë ku nga disa pozicione të ndryshme janë gjuajtur me arsenal armësh të zjarrit, përfshirë këtu edhe me granata dore dhe zollë, ku si pasojë e gjuajtjeve janë qëlluar me armë zjarri dy zyrtarë policorë.*
>
> *Njësitet policore në vetëmbrojtje i janë përgjigjur sulmit dhe kanë arritur që ta zmbrapsin sulmin fillestar për të krijuar kushte për dhënien e ndihmës dhe tërheqjen e kolegëve të qëlluar me armë zjarri.*
>
> *Zyrtarët policorë të plagosur janë tërhequr nga lokacioni dhe janë transportuar në Spitalin Rajonal në Mitrovicë Jugu, ku nga mjeku kujdestar është konstatuar vdekja e njërit nga zyrtarët policor të plagosur rëndë, ndërsa dy zyrtarë të tjerë, njëri i plagosur dhe tjetri i lënduar, sipas mjekëve janë jashtë rrezikut për jetë dhe të njëjtit janë transportuar në SHSKUK për trajtim të mëtutjeshëm mjekësor.*
>
> *Të gjitha njësitë policore relevante sipas profileve janë aktivizuar në teren, të njëjtat kohë pas kohe janë duke u sulmuar me armë zjarri nga pozicione të ndryshme, nga grupe të organizuara dhe të armatosura.*
>
> *Policia e Kosovës në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet kompetente dhe organet e drejtësisë, po ndërmerr veprimet e saja me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike si dhe sjelljes para organeve të drejtësisë së kryerësve të sulmeve ndaj zyrtarëve policor.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:28

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Osmani ndërpret vizitën në New York

Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani, e ka ndërprerë vizitën zyrtare në New York, pas ngjarjes së rëndë në veri ku një polic mbeti i vrarë pas një sulmi me armë. Kjo u konfirmua nga këshilltari për media Bekim Kupina.

Kupina tha se Osmani sot do të niset për Kosovë.

> *"I ka anuluar të gjitha aktivitetet e parapara për të hënën dhe të martën në New York", tha Kupina për Klan Kosova.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:22

Afrim Bunjaku, polici i dytë që vritet në veri të Kosovës në krye të detyrës

Rreshteri policor Afrim Bunjaku bëhet polici i dytë i Republikës së Kosovës që vritet në veri të vendit, teksa ishte në detyrë.

Efektivi i forcave të rendit nga Samadrexha e Vushtrrisë u qëllua për vdekje sot rreth orës 3 të mëngjesit, në një pritë nga persona të maskuar në Banjskë të Zveçanit. Ata i kanë bllokuar rrugën makinës së Policisë në Mitrovicë- Leposaviç me dy kamionë dhe më pas kanë qëlluar me armë në drejtim të tyre. Për pasojë, u plagos edhe një person tjetër.

Bunjaku është polici i dytë që vritet në veri të Kosovës, ndërsa në vitin 2011 Enver Zymberi, nga Dubovci i Vushtrrisë ra në krye të detyrës. Ai u vra më 26 korrik 2011, gjatë aksionit të forcave të republikës së Kosovës për ta shtrirë kontrollin në veri të vendit.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:03

Vrasja e policit në Kosovë, dy kamionë bllokuan rrugën Mitrovicë-Leposaviç dhe persona të maskuar qëlluan në drejtim të makinës së policisë

Polici Afrim Bunjaku ka mbetur i vrarë në veri të Kosovës, pas një sulmi me armë. Klan Kosova shkruan se persona të maskuar i kanë bllokuar rrugën makinës së Policisë në Mitrovicë-Leposaviç me dy kamionë dhe më pas kanë qëlluar me armë në drejtim të tyre. Për pasojë, mbeti i vdekur polici Bunjaku dhe një tjetër është plagosur.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:54

Osmani për vrasjen e policit në veri: Sulm ndaj Kosovës, e orkestruar nga Serbia

Presidentja Vjosa Osmani, ka reaguar pas vrasjes së një polici të Kosovës dhe plagosjes së një tjetri në veri të Kosovës. Osmani tha se vrasja dhe plagosja e një polici në veri është e planifikuar, orkestruar dhe ekzekutuar nga bandat kriminale serbe, teksa e quajti sulm ndaj Kosovës.

> *"Këto sulme dëshmojnë edhe njëherë fuqinë destabilizuese të bandave kriminale, të organizuara nga Serbia, të cilat prej shumë kohësh, siç është dëshmuar edhe me sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it, gazetarëve e qytetarëve, po synojnë të destabilizojnë Kosovën dhe rajonin".*
>
> *"Sulmet e organizuara kundër forcave të rendit të Republikës së Kosovës janë sulme kundër sovranitetit të Republikës së Kosovës", tha Osmani.*

Më tej, ajo tha se pret që aleatët e Kosovës ta mbështesin vendin në përpjekjen për të vendosur rend e ligj në çdo pjesë të Republikës.

> *"Familjes së policit të vrarë ju shprehim ngushëllime të thella dhe i sigurojmë se autorët e këtyre akteve terroriste nuk do të mund t'i ikin drejtësisë".*
>
> *"Ftoj të gjithë qytetarët, institucionet dhe subjektet politike që të qëndrojnë të bashkuar në këtë kohë kur nga Serbia po sfidohet hapur integriteti territorial, siguria dhe sovraniteti i Republikës sonë".*
>
> *"Si Presidente e Republikës kam besimin e plotë në djemtë dhe vajzat tona nga Policia*

e Kosovës", tha Osmani.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 07:52

EMRI/ Ky është polici i cili mbeti i vrarë në veri të Kosovës

Një polic është vrarë dhe një tjetër është plagosur në fshatin Banjskë në veri të Kosovës.

Klan Kosova shkruan se polici i vrarë është Afrim Bunjaku, nga fshati Samadrexhë e Vushtrrisë.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Sl.E./M.Q./Shqiptarja.com

TAG: tensione ne veri te kosoves | vritet polici ne kosove

Komento

Komente

Shkoder: 24/09/2023 16:49

Te ekzekutohen ato 30 lepujt . Bravo Albin . Jo si kto shqiptaret qe po ja japin falin edhe himaren greqis vetem e vetem me qene ne pushtet.

Përgjigju

Turi: 24/09/2023 16:44

Ti vrasin te gjithe mos te len asnje gjalle. Ta din kush shkel token tone dhe vret SHQIPTARE DUHET TE VDESI. I VRINI TE GJITHE. 1 me 30 ashu e con gjakun e deshmorit ne vend.

Përgjigju

Dordomusi: 24/09/2023 16:36

Ne 2025 ka lufte ne Ballkan kjo gje dihet qe para 10 vitesh...kshu qe çdo gje po shkon sipas planit !!!

Përgjigju

ADD: 24/09/2023 16:36

Armiku më i modh i Shqiptarisë ësht Serbia. Pastaj me rradhë Franc,Greqi etj etj.. Nëse Kurti do të vej dinjitetin në ven duhet të qërojn të gjith grupin që kan gjujt ndaj Policisë së Kosovës.

Përgjigju

Miri: 24/09/2023 16:09

Serbia te rri urte me ato barbonat e ve se dojn me ja pa hajri per dyten her shqiprija 1

Përgjigju

Ndergjegja: 24/09/2023 15:43

Borrell@Lajçak@Eskobar jane TRE ELEMENTE MBESHTETES TE LINJES NACIONALISTE MOSKË-BEOGRAD. ESHTE TURPESHME SJELLJA E QENDRIMI TYRE,LOBISTE TE MOSKES E BEOGRADIT. USA@BE DUHET TE NDERMARRE VEPRIME AKTIVE TE MENJEHERSHME PER ESKALIM TE SITUATES TEPER TE RREZIKSHME-LUFTE BALLKANIKE QE DO PERFSHIJE EVROPEN MBARE.

Përgjigju

Gjergj: 24/09/2023 15:28

Edi Rama, kryministri i vèndit tim,,,JU LUTEM, pèr Kosovèn, le tè lèmè Albin Kurtin tè bèjè atè qè duhet bèrè. A e kuptoni ju, qè me dèrrdèrret tuaja me "Sandrin, shokun serb" dhe "ballkonet e ndryshkura kot", nuk ka vènd mè pèr ju PÈR ASGJÈ nè çèshtjen e Kosovès? Èshtè metoda juaj e qeverisjes, ku rrumpalla èshtè mbi strategjinè kombètare, arsyeja pse ju nuk bindni mè askènd,nè kètè konflikt shqiptaro-serb. Ju u prononcuat,,,dhe dolèt bllof. Tani, lèrini ata qè patèn tè drejtè, tè bèjnè punèn e tyre.

Përgjigju

Bekim: 24/09/2023 15:09

Nje akt subversiv, terrorist, i Serbise nen udheheqjen direkte te kriminelit te kuq Aleksandar Vucic! Operacion i ngjashem me ate te Rusise ne nisje te luftes ne Ukrahine! Kuraje policise, forces se sigurise dhe popullit te Kosoves ne detyren e tyre te mbrojtjes dhe neutralizimit total te ketij kercenimi. Turp dhe faqe e zeze per lidershipin shqiptar qe ne vend te identifikoje Serbine per aktin subversivo-terrorist, te mbeshtese me inteligjence dhe pse jo forcen tone policore dhe ushtarake Kosoven, ben thirrje jo neutralizoje kercenimin por "ti nxjerre para drejtesise".

Përgjigju

Bravo policia: 24/09/2023 15:07

Vritini te gjith , ku jan snaiperistat e policis se kosoves ?? Shkoni menjeher e vritini te gjith se jan ne faj nuk do ju thot njeri gje

Përgjigju

Shkodra: 24/09/2023 14:04

Po futjani edhe ju vrajini 2-3 vet ta shofin mir ato pastaj

Përgjigju

Fshqip: 24/09/2023 13:44

Zoti rama do flasi me vucic dhe do ta ngjalli policin e vrare

Përgjigju

Alb: 24/09/2023 13:41

Herete e vone do kemi edhe nje her lufte me serbine, ky ashte i lajme i mire per shqipnin e madhe, pa lufte nuk vjen bashkimi

Përgjigju

Taku: 24/09/2023 13:32

Mendoj qe drejtesia ne kete rast behet duke kaluar ne plumb te 30 kriminelet. Ngushellime familjes.

Përgjigju

> **Arben:** 24/09/2023 13:49
>
> Jo. Aty le te rrine tek ai manastir te rrethuar, po deshen edhe nje vit! Ata 30 kriminele mire qe po na japin sebep qe te pastrojme njehere e mire Kosoven nga ardhacaket serbe. Kurti duhet te veproje!

Agimi iLkrë: 24/09/2023 13:27

Akkma .ë zyfë je o"baca;kurt e"zonja" osmani a ju kan mbaruar armët A .Ndiq RRUGËN E ADEM JASHARIT, nëtë kundërt largohu, ku nuk të njohin(në karundin e gruas) bre mashkull se burë nuk je.

Përgjigju

GOLI: 24/09/2023 13:20

SERBIA ESHTE ARMIK,KA QENE DHE DO TE JETE....ARMIKUN DUHET LUFTUAR DHE DUHET ZHDUKUR....ME VAJTJEN E USHTRISE SHQIPERARE TE KOSOVES DHE USHTRISE SHQIPETARE TEK MOLLA A KUQE-ZGJIDHET ÇESHTJA.

Përgjigju

Fshati: 24/09/2023 13:03

Faji i ngelet gjithmone me budallait. Dhe kur sheh politikanet tane, faji do te na ngelet neve. Po nuk po na kerkuan demshperblim per krimet e luftes politikanet tane e shohin si fitore dhe reciprositet.

Përgjigju

XXX: 24/09/2023 13:00

Me sa degjojme eshte pershkallzue situata.Fajtoret ne kete histori jane BE dhe SHBA.Nuk mund te jete zgjidhje ,krijimi i asocacineve,i pamvarur nga qeveria e kosoves.Ato jane zona me popullesi dominuese serbe dhe duhen trajtuar si i trajton e gjithe bota minoriteret.Te gjitha situatat qe kane ndodhur,qe po ndodhin e qe do te ndodhin,nuk bejn pergjegjes Albin Kurtin.SHBA dhe BE ta marrin ne dore situaten.Duhet konsulte popullore,mbarekombetare se si te zgjidhet problemi.Kete te bejne nderkombetaret.Situata nuk duhet nenvleftesuar.

Përgjigju

Ndergjegja: 24/09/2023 12:49

Politike e piste e qarqeve nacionaliste Beograd-Moskë dhe e lobeve te tyre nga Brukseli e deti ne Vashington. Brukseli dhe Vashingtoni duhet te ezauroje keto lobe te fuqishme nacionaliste qe ne fakt jane vatra lufte.

Përgjigju

Njoni: 24/09/2023 12:35

Keto jon ata pjestaeret e wanger qe u largun nga ukrahina per në Belarus. I vrisni te gjith.

Përgjigju

Fatosi-kosove: 24/09/2023 12:32

Pamje te tilla me neverisin, dhe quditem se si ka ftyre allbin kurrci te shoke ta viziton policin e olagosur pas gjithe ketyre poshtersive, pastaj ajo mender presednike osmanka sikur nderprene viziten turistike me bourrin sepse qenka e shqetesuar aq sa edhe vuqiqi,kurse europa thot se policia e kosoves duhet te largohet nga veriu,mos ndoshta edhe nga kosova per Tia leshuar vendin policise dhe ushtrise serbe siq po kerkon vuqiqi dhe llajqaku, kam frike se po vendoset nje far plani i fshehur mes serbise dhe europes e le ndihmen e tbijes se milicit te milloshеviqit si dikur ne qeqeni, ju kujtohet besoj, sot kadorovi komandant i putinit ndoshta neser osmanka komandante e vuqiqit dhe llajqakut kurse kurrcyle ta kerkon biren e minit.

Përgjigju

Anti Serbi: 24/09/2023 11:35

Ngushllime familjes te policit te vrare nga dora kriminale Serbe! Te futen ne teritorin tend 15 km dhe te vrasi ,aty sikur nuk paska as polici as ushtare te kufirit. Fajin nuk e ka as Mero as Lajçak po Albini! por shteti Kosovar dhe Kfori qe nuk monitorojne kufirin!nga kane hyre keto kriminel me mjete te blinduara 15 km ne thedhsi te territorit Kosovar? Shteti Kosovar dhe Kfori duhet te jene pergjegjes per vrasjen e policit fat keq.

Përgjigju

Shqipëria: 24/09/2023 10:55

Presim Mero bazen e Lajçak të thonë fajin e ka Albini se i vrau vetë.

Përgjigju

Malsori: 24/09/2023 10:38

Prisni o burra se eshte dite e diele ende nuk jane zgju nga gjumi trimat e Facebook.. Kane qene ne disko mbreme, andej nga dreka apo darka do shihni do behet nami me video e postime me foto nga tutaxhinjte dhe mjekeroshet mbipeshe qe shajne nga motra Serbine dhe bejne gishtat shqiponje.. Nuk vdes kombi shqiptare sa te jete llumi ne Facebook qe kendon kenget tallava patriotike. Hajde luj qyqek.

Përgjigju

Agimi iLirë: 24/09/2023 09:48

Më falni por nuk kuptoj informacionin e presidencës që trupa e mjete luftarake sërbe kan hyrë në teritorin e REP. KOSOVËS dhe jan lënë të dalin të gjallë nga ajo tok????.Qënkemi në dorë të hasmit o popull shqiptar.Në burg Presidentia,kryeministri,M.M.Na rofshln lajmet me 300 petrita të rinj.LAVDI ADEM JASHARIT.

Përgjigju

> **Eri:** 24/09/2023 12:14
>
> Ik o Arber pirdhu, ta ka fajin Edi Rama ty SE nuk mbroni dot kufirin tuaj. Mgjt Ed rames rropt ku ti ket per qejf.

> **Arbëri:** 24/09/2023 10:46
>
> Në Burg më PJESTAR TË KFORIT së pari dhe në Burg më Edvin shkjaun shqipfolës që Na mori në qafë më vllaun e ti Vucicin fashist

Kurthi: 24/09/2023 09:41

Këto janë provokime të mirë menduara. Që të destabilizohet rajoni. E kuptoni loja kujt bëhet? Mjafton të "qortohet" 'Vuqiqi' që pastaj të ketë gojë e të thotë "vetë më shtytë t'i kërkoj ndihmë vllait të madh". Dhe më e keqja është se disa në Kosovë mezi presin që të acarohet gjendja.

Përgjigju

Arben: 24/09/2023 09:25

Ca do thone tani Eskobar e Lajcak? Prape Kosova e ka fajin? Turp! Serbia me keto vrasje tregon qe nuk meriton as te jete me pjesemarrese ne dialog por duhet te shpallet shtet terrorist dhe te izolohet nga e gjithe bota!

Përgjigju

> **Edi:** 24/09/2023 09:46
>
> Çfarë do thotë Edi Rama!? Open Balkan.

> **Tao:** 24/09/2023 09:46
>
> Fatkeqësisht atë do thonë pasi për këtë arsye i kanë kërkuar deeskalimin e situatës qeverisë së Kosovës. Nuk kanë qenë kurrë në rrezik civilët serb nga lëvizjet e qverisë së Kosovës, në rrezik kanë qenë forcat policore shqiptare. Ngushëllime familjes së policit të vrarë, shërim të shpejtë policit tjetër.

Agimi i Lirë: 24/09/2023 09:02

Ngushëllime të ndjera familjes të të ndjerit.Po,nuk e kuptoj lajmin që dy kamion bllokojnë rrugën dhe u qëlluan??? Ajan,profesionist eprorët etyre?Nuk e kuptoj që drehtuesit e strukturave të UÇK e negjithëse vullnetar qëndrojnë më lartë se trupa komanduese e sotme e policis. E them këtë sps jan në pushtet dhejo në mal.

Përgjigju

Deni: 24/09/2023 08:53

OKurti o te dhjefsha dronet qe na mburreshe aty duheshin dronet jo i con ata djem drejt vdekjes.

Përgjigju

Topi: 24/09/2023 08:42

Mos shkoni si capi tek kasapi. Ngrihuni kurth herën tjetër e i bombardoni me dronë si minjtë këta serbo kriminela

Përgjigju

Vuçiç: 24/09/2023 08:37

Bllokohet rruga me kamionë, mos dërgoni policë. Dërgoni dronë bayraktar e hidhini në erë.

Përgjigju

Papa: 24/09/2023 08:33

Reagimet me fjal jan te papes kurse shteti per zonat e rrezikshme duhet ti shikoi me dron bajraktar te armatosur

Përgjigju

> **Albini:** 24/09/2023 09:04
>
> S'ka rëndësi kush i organizon këto sulme Serbia, Rusia, Bjellorusia etj. Reagimi duhet të jetë i përgatitur që mos ketë viktima nga policia, i fortë dhe të marrin pergjigjen e merituar kriminelët.

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Ndryshe nga biznesi i vogël profesionet e lira do të tatohen, si ju duket?

E drejtë | E gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera



Përgjaket veriu i Kosovës, Deputetja britanike: Të gjithë ata që e kanë nisur këtë sulm do japin llogari dhe do dalin para drejtësisë
24 Shtator, 16:46

Tensionet në veri të Kosovës/ Shefi i EULEX dënon sulmin: Jemi të gatshëm të përkrahim institucionet e Kosovës
24 Shtator, 15:47

Shkupi: Sulmi ndaj Policisë së Kosovës është një akt i rëndë destabilizues
24 Shtator, 15:35

Tensionet në veri të Kosovës, ndërkombëtarët: Dënojmë sulmin e tmerrshëm, autorët të dalin para drejtësisë! Palët t'i kthehen dialogut
24 Shtator, 15:31

Tensione në veri të Kosovës/ Gërvalla reagon ashpër ndaj Borrell: E turpshme, asnjë fjalë kundër terroristëve që vrasin policët
24 Shtator, 15:21

Sveçla: Grupet e armatosura të dirigjuara nga Beogradi! Burimi i sulmit manastiri në Banjska! Po sulmohemi nga pozicione të ndryshme
24 Shtator, 13:59

Dalin Fotot/ Ja formacioni i armatosur që vrau efektin në Kosovë, të veshur me veshje ushtarake e autoblinda
24 Shtator, 13:04

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Basha: Beogradi ta dënojë dhe të distancohet nga kjo ngjarje
24 Shtator, 09:15

Vrasja e policit në veri të Kosovës, Rama: BE të marrë masa për moseskalimin e situatës! Begaj: Akti kriminal! Opozita: Autorët të dalin para drejtësisë
24 Shtator, 09:11

Begaj për 'VOA'-n: Prishtina të ndjekë sugjerimet e SHBA-ve për dialogun me Serbinë, nuk kemi nevojë për vetëizolim
22 Shtator, 18:35

Rikthehen tensionet në veri të Kosovës? Shpërthim në Mitrovicë
22 Shtator, 08:50

Osmani reagon për tensionet në veri: Kosova është gati për zgjedhjet në komuna, problemi qëndron tek serbët
14 Shtator, 14:27

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje